



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK

**VENDIM**

**Nr. 125, datë 28.09.2020**

**“PËR  
TRANSFERIMIN KAPITAL TË MJETIT TË TRANSPORTIT NGA QENDRA  
KOMUNITARE “TË QËNDROJMË SË BASHKU” TE QENDRA KOMUNITARE E  
TERRENIT**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.1, shkronja “b”, nenit 54, shkronja “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr.10296, datë 8.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, ligjit nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, pikës 2, shkronja “ç”, tëvendimit nr. 153, datë 3.4.1993, të Këshillit të Ministrave “Për kalimin e objekteve të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore”, të ndryshuar, Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, të Ministrit të Financave “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar, Vendimit nr. 10, datë 27.02.2015 “Për transferimin kapital të mjetit të transportit dhe të paisjeve të inventarit ekonomik dhe pajisjeve teknike nga aparati i bashkise së Tiranës në njësitë shpenzuese që i kanë në përdorim”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D O S I :**

1. Transferimin kapital pa pagesë nga inventarët e Qendrës Komunitare “Të Qëndrojmë së Bashku” te inventarët e Qendrës Komunitare të Terrenit të mjetit të transportit me targë TR 9475 R, me vlerë 665,917 lekë, sipas dokumentacionit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohen Qendra Komunitare “Të Qëndrojmë së Bashku” dhe Qendra Komunitare e Terrenit, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

**K R Y E T A R**

**TONI GOGU**